



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 132 Prot.

Tiranë, më datë 24.08.2023

VENDIM
Nr. 449, datë 24.08.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, Vendim Nr. 220, datë 07.04.2021 “Për Përcaktimin E Procedurave Për Hulumtimet Arkeologjike, Të Kushteve Të Posaçme Të Lëshimit Të Lejes, Dokumenteve Shoqëruese, Si Dhe Procedurave Për Shqyrtimin Ose Anulimin E Lejes Për Kryerjen e Hulumtimeve Arkeologjike” dhe “Regullorja e arkeologut”, me Vendim Nr. 2, datë 30.01.2009, të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 24.08.2023:

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit kërkimor-shkencor në vazhdim “Lugina e Shushicës: qytezë, tempuj, kisha”, me bashkëdrejtuese projekti Dr. Sabina Veseli;
2. Para fillimit të projektit të bëhet njoftimi zyrtar pranë IKTK-së dhe DRTK-së përkatëse;
3. Pas përfundimit të projektit, një kopje e dokumentacionit si dhe lista e gjetjeve arkeologjike të depozitohen pranë IKTK-së dhe IKRTK-së;
4. Dokumentacioni i hartuar në kuadër të këtij projekti për vitin 2023 të dorëzohet pranë IKTK-së;
5. Afati përfundimtar i punimeve është një vit nga miratimi në KKTKM;
6. Afati përfundimtar i punëve do të jetë sipas planit të punës të depozituar në IKTK;
7. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
8. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R
Elva MARGARITI

SEKRETAR
Klesta QIRICI

Klesta
Qirici

Digitally signed by
Klesta Qirici
Date: 2023.08.25
13:30:43 +02'00'

Elva
Margariti

Digitally signed by Elva
Margariti
Date: 2023.08.25
13:40:15 +02'00'